



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 25 shtator 2015  
Ref. Nr.: RK 843/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 39/15**

Parashtrues

**Fetije Haliti**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 4/2015, të 27 shkurtit 2015.**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, Kryetare  
Ivan Čukalović, zv. Kryetar  
Robert Carolan, Gjyqtar  
Altay Suroy, Gjyqtar  
Almiro Rodrigues, Gjyqtar  
Snezhana Botusharova, Gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, Gjyqtar

## **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Fetije Haliti (në tekstin në vijim: parashtruesja), nga fshati Kushevicë, Komuna e Podujevës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimit i Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 4/2015, i 27 shkurtit 2015, të cilin parashtruesja pohon se e ka pranuar më 14 mars 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja pretendon se i janë shkelur të drejtat kushtetuese, pa specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta).

## **Baza Juridike**

4. Bazë e parashtrimit të kërkesës është neni 113 (7) i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit, dhe rregulli 56 i Rregullores së punës.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 25 mars 2015, parashtruesja dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar.
6. Më 22 prill 2015, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. GJR. KI 39/15, caktoi Gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. KSH. KI 39/15, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 18 maj 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
8. Më 1 korrik 2015, me Vendimin Nr. K.SH.KI 39, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i ka përfunduar mandati në Gjykatën Kushtetuese më 26 qershor 2015.
9. Më 10 shtator 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhje e fakteve

10. Më 30 shtator 2010, Komisioni për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) në shfrytëzim me qira për rastet në përkujdesje sociale, përmes Njoftimit nr. 02. nr. 360-254, ka informuar parashtruesen se është refuzuar kërkesa e saj për dhënie të banesës në shfrytëzim me qira për rastet në përkujdesje sociale, me arsyetimin se nuk përbënë një rast social.
11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja përmes padisë së parashtruar pranë Gjykatës Supreme të Kosovës për hapjen e konfliktit administrativ, kontestoi Njoftimin e lartëcekur për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore.
12. Më 29 nëntor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas padisë së parashtrueses, me Aktgjykimin A. nr. 1074/2011, aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses dhe anuloi Njoftimin e Komisionit 02. nr. 360/254, të 30 shtatorit 2010. Kjo gjykatë *inter alia* arsyeton se:

*“Gjykata konstaton se në rastin konkret organi i paditur [Komisioni] ka shkelur ligjin në dëm të paditësit [parashtrueses], sepse vendimi-njoftimi i përmendur nuk mund të konsiderohet i drejtë dhe i bazuar në ligj.*

*[...] duhet të jepen domosdoshmërisht arsye për të gjitha ato akte për të cilat pjesërisht ose plotësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë ase prekin në ndonjë mënyrë të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime [...]”.*

13. Më 27 dhjetor 2011, Avokatura Publike Komunale në Prishtinë parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1074/2011, të 29 nëntorit 2011, përmes të cilës kërkoi shfuqizimin e këtij aktgjykimi.
14. Më 20 mars 2012, parashtruesja përmes përgjigjes në ankesë, kontestoi ankesën e palës së paditur [Komisionit] me pretendimin se është e pabazuar.
15. Më 10 korrik 2012, Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin A.A. nr. 201/2011, refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së paditur dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1074/2011, të 29 nëntorit 2011, me arsyetimin se:

*“[...] në kuptim të nenit 11 të LPA [Ligji për Procedurën Administrative], e paditura ka qenë e detyruar që lidhur me kërkesën e paditëses të vendos me aktvendim[...].”*

16. Më 5 gusht 2012, Komisioni, duke vendosur në procedurën e rishqyrtimit, me Aktvendim e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses 02. nr. 360-254, të 30 shtatorit 2010, me arsyetimin se parashtruesja nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me Rregulloren për dhënien e banesave për shfrytëzim me qira për

rastet në përkujdesje sociale, sepse sipas këtij Komisioni parashtruesja nuk i përket kategorisë së personave që janë raste sociale.

17. Kundër Aktvendimit të Komisionit të 5 gushtit 2012, parashtruesja më 6 nëntor 2012, ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, përmes të cilës ka kërkuar anulimin e Aktvendimit në fjalë.
18. Më 22 janar 2013, parashtruesja është ankuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor lidhur me zvarritjen e vendosjes për lëndën e tij, nga Gjykata Supreme e Kosovës (tani Gjykata Themelore në Prishtinë).
19. Më 15 prill 2013, Zyra e Prokurorit Disiplinor përmes shkresës me nr. ZPD/13/zp/290, e informoi parashtruesen se kjo zyrë nuk ka gjetur bazë ligjore për të hapur hetim disiplinor lidhur me ankesën e saj, si dhe e informoi që lënda e në fjalë është ndarë tek gjyqtari dhe është në pritje për t'u vendosur.
20. Më 3 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative duke vendosur sipas padisë së parashtrueses, me Aktgjykimin A. nr. 1126/2012, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e saj. Ndër të tjera, kjo gjykatë arsyeton se:

*“[...] paditësja gjatë vitit 2010 është evidentuar si banore e Komunës së Podujevës, andaj Komisioni me të drejtë ka konstatuar se paditësja nuk e ka përmbushur kriterin e përcaktuar me nenin 7 pika (b) të Rregullores. Poashtu, Komisioni me të drejtë ka konstatuar se paditësja nuk ka qenë në listën e personave apo familjeve që marrin ndihmë sociale nga MPMS-së dhe me rastin e aplikimit nuk e ka dorëzuar Vërtetimin e lëshuar nga Qendra për Asistencë Sociale.*

*“[...] paditëses i është njohur e drejta në pension të Invalidëve Civil andaj nuk ka mund të marrë ndihma sociale dhe të ketë statutin e rastit social, por megjithatë gjykata vlerëson se ky fakt nuk ka ndikim në fitimin e të drejtës së paditëses për shkak se në konkursin konkret, banesat kanë qenë të dedikuara për rastet sociale e jo për invalidët e luftës[...].”*

21. Me një datë të pacaktuar, parashtruesja ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me pretendimin se është bërë vërtetimi jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike dhe shkelja e dispozitave materiale e procedurale.
22. Më 7 tetor 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin AA. Nr. 327/2014, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A. nr. 1126/2012, të 3 qershorit 2014. Kjo gjykatë *inter alia* arsyeton se nuk ka dëshmi se parashtruesja në kohën e aplikimit ka qenë banore e Komunës së Prishtinës së paku pesë vitet e fundit siç parashihet me Rregullore, si dhe e njëjta nuk ka qenë përfituese e ndihmës sociale por ka qenë përfituese e pensionit si invalid civil i luftës.

23. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesja në një datë të pacaktuar ka parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
24. Më 11 dhjetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin Rev. A. nr. 16/2014, hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtrueses për revizion, me arsyetimin se kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë në çështjet administrative pala mund të parashtrojë vetëm kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit, e jo kërkesë për revizion.
25. Më një datë të pacaktuar, parashtruesja parashtroi në Gjykatën Supreme të Kosovës kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA. nr. 327/2014, të 7 tetorit 2014, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe materiale.
26. Më 27 shkurt 2015, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin ARJ-UZVP. nr. 4/2015, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Në këtë vendim, gjykata ndër të tjera arsyeton se:

*“[...] në datën e aplikimit paditësja nuk ka dëshmi se ka qenë banore e KK Prishtinës, së paku 5 vitet e fundit dhe po ashtu e njëjta nuk ka qenë përfituese e ndihmës sociale.”*

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

27. Parashtruesja pretendon se Aktgjykimi ARJ-UZVP. nr. 4/2015, i 27 shkurtit 2015, i Gjykatës Supreme të Kosovës shkel të drejtat e saj kushtetuese. Faktikisht, parashtruesja nuk ka precizuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës që pretendon se i është shkelur, por nga rrethanat e rastit supozohet se bëhet fjalë për pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.
28. Për më tepër, parashtruesja kërkon si në vijim: *“kërkoi që të më ndahet një banesë për qështje sociale-për viktimat civile të luftës, pasi që jam invalide, e papunë, e pamartuar dhe e mbaj babain tim të smur i vjetër 86 vjeçar, i sëmur dhe banojmë te djemt e tezës në Prishtinë- nga viti 2000”.*

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

29. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara me Ligj dhe me Rregulloren e punës.
30. Në këtë drejtim Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili përcakton se:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*



31. Përveç kësaj, neni 47 (2) i Ligjit përcakton se:

*“Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

32. Gjithashtu, Gjykata në këtë rast i referohet edhe rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*b) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar,*

*[...]*”

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm, dhe se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është vendimi i fundit në çështjen e parashtrueses, andaj në këtë kontekst parashtruesja është palë e autorizuar.

34. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar [...]”.*

35. Gjithashtu, Gjykata merr në konsideratë rregullat 36 (1) (d), 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do ta deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

*[...] ose*

*d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

36. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konsideron se vetë fakti se parashtruesja nuk është e kënaqur me vendimin e kontestuar nuk do të thotë se ky vendim cenon të drejtat kushtetuese të saj.

37. Në këtë kontekst, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në raport me vendimet e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që duke konstatuar gjendjen faktike, t'i zbatojnë dispozitat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin *KI 70/11, Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

38. Mandati i Gjykatës Kushtetuese në raport me vendimet e gjykatave të rregullta dhe me vendimet e autoriteteve tjera publike, është vetëm shqyrtimi dhe vlerësimi nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në atë mënyrë që parashtrueses t'i kenë siguruar një gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
39. Bazuar në shkresat e lëndës së parashtrueses, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në vendimin e kontestuar është i qartë dhe shikuar në tërësi procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (*mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).
40. Rrjedhimisht Gjykata konsideron se parashtruesja nuk i ka mbështetur pretendimet e saj dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi që *prima facie* do t'i arsyetonte këto pretendime për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
41. Për arsytet e lartëcekura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesja në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e saj për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe parashtruesja nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme, si dhe pse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë.
42. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtrueses nuk i përmbushë kriteret procedurale për pranueshmëri, për shkak se është qartazi e pabazuar.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d), 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2015, njëzëri:

### VENDOS


- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

  
Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Arta Rama-Hajrizi